

Albin Gega

Z. Albin Gega ka kryer studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë, Dega Juridik, si dhe në Fakultetin e Shkencave Sociale, Dega Shkenca Politike, në Universitetin e Tiranës. Ka kryer studimet pasuniversitare pranë Institutit të Studimeve Evropiane, i binjakëzuar me Universitetin e Katalunjës, Spanjë, ku është diplomuar për Master në Studime Evropiane.

Z. Gega vjen nga një eksperiencë e gjatë pune, fillimisht në fushën juridike në sektorin privat e më pas në Inspektoratin Ndërtimor dhe Urbanistik Kombëtar, si dhe në pozicione drejtuese në administratën publike si: Nëndrejtor i Përgjithshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë; Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë; Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Turizmit dhe njëkohësisht Drejtor i Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Turizmit, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit; fillimisht Drejtor në Drejtorinë e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional e më pas Drejtor i Përgjithshëm, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Punësimit, Aftësimit dhe Sigurimeve Shoqërore, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Me një karrierë të pasur dhe arritje të shumta, kryesisht në fushën e Arsimit dhe Formimit Profesional, ai ka kontribuar ndjeshëm në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për ndërmarrjen e një sërë ndryshimesh në favor të zhvillimit të Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional. Ai është vlerësuar pozitivisht edhe nga partnerët për efikasitetin e treguar në drejtimin e kësaj strukture, si dhe performancën e lartë në realizimin e detyrave.

Krahas përvojës menaxhuese të krijuar gjatë ushtrimit të detyrave të shumta, z. Gega ka marrë pjesë edhe në shumë konferenca dhe seminare ndërkombëtare, në fushat e turizmit, punësimit dhe aftësimit profesional, sigurimeve shoqërore, etj.